



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 64 Prot.

Lezhë, më 27.01.2020

U R D H Ë R

Nr. 08 datë 27.01.2020

**PËR
KRIJIMIN E TASK FORCËS-VENDORE PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBETAR
TË VEPRIMIT KUNDER KULTIVIMIT DHE TRAFIKIMIT TË KANABISIT**

Bazuar në ligjin nr.107/2016 "Për prefektin e qarkut", neni 8 germa "e", Urdhërin nr.51 datë 13.04.2017 pikat 10, 11 dhe 12 të Kryeministrit, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave drejtuese dhe koordinuese ndërinstitucionale në nivel qendror dhe vendor, të ngarkuara me përgjegjësinë e zbatimit të planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017 – 2020",

U R D H Ë R O J :

- Krijimin e Task – Forcës Vendore (TFV)** për realizimin e koordinimit dhe bashkëveprimit efektiv në nivel vendor, shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira, hartimin e vlerësimeve të përbashkëta, si dhe realizimin e operacioneve të përbashkëta në zbatim të detyrimeve të parashikuara në planin e veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017 – 2020 me këtë përbërje:

Prefekti	Kryetar
Perfaqësues i Drejtorisë Vendore të Policisë	anëtar
Perfaqësues i Prokurorisë së Rrethit Gyqësor Lezhë	"
Perfaqësues i Prokurorisë së Rrethit Gyqësor Kurbin	"
Perfaqësues i Drejtorisë Rajonale të SHISH	"
Perfaqësues i Drejtorisë Rajonale të SH S SH	"
Perfaqësues i Degës së Doganës Shëngjin	"
Perfaqësues i Zyrës Vendore Arsimore Lezhë	"
Perfaqësues i NJ V K SH Lezhë	"
Perfaqësues i Agjencisë Rajonale të Ekst. Bujq. Shkodër	"
Perfaqësues i Bashkisë Lezhë	"
Perfaqësues i Bashkisë Kurbin	"
Perfaqësues i Bashkisë Mirditë	"
Perfaqësues i Administratës Rajonale të Z M	"
Perfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve	"
Perfaqësues i Rep. Usht. nr. 1010. B 1 K Vau i Dejës	"
Perfaqësues i I SH M P U T Lezhë	"
Perfaqësues i Drejtorisë Vendore për Kufirin & Migracionin	"
Perfaqësues i Policisë Ushtarake SPU (Shkodër)	"

Task – Forca Vendore të marrë masa për:

1. Administrimin dhe monitorimin e planeve të veprimit të strukturave të përfshira në TFV.
2. Titullarët e institucioneve të përfaqësuara në Task – Forcën Vendore, të paraqesin emrat e anëtarëve perkatës tek prefekti.
3. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të bashkive në task – forcën vendore të rregullohet me marrëveshje ndërmjet prefektit të qarkut dhe kryetarëve të bashkive perkatëse.
4. Strukturat e perbashkëta të task – forcës vendore të hartojnë dhe të paraqesin në strukturat eprore dhe të titullarët e institucioneve të përfshira, raporte të integruara mujore si dhe vlerësime të veçanta rreth të gjitha masave të parashikuara nga plani i veprimit.
5. Ngarkohen drejtuesit e institucioneve të përfshira në këtë task - forcë për zbatimin me perpikmëri të këtij urdhëri, sipas planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit dhe grafikut të shkeljes së territorit
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PREFEKTI

Gjokë JAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 07 Prot.

Lezhë, më 04 .01.2024

URDHËR
Nr. 01 datë 04.01.2024

PËR

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT RAJONAL TË
PARANDALIMIT TË RADIKALIZMIT DHE LUFTËS KUNDËR EKSTREMIZMIT
TË DHUNSHËM, NË QARKUN LEZHË**

Bazuar në ligjin nr.107/2016, “Për prefektin e qarkut“, neni 8 germa "e“, urdhrin nr. 185 datë 31.10.2023 të Kryeministrit, “Për ngritjen dhe funksionimin e komiteteve rajonale për parandalimin e radikalizimit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm”, VKM nr.81 datë 14.02.2023 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit 2023 – 2025 dhe planeve të veprimit 2023 – 2025”,

URDHËROJ :

1. Ngritjen e komitetit rajonal për parandalimin e radikalizimit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm në qarkun Lezhë.
2. Komiteti rajonal drejtohet nga prefekti i qarkut dhe ka në përbërje këta anëtarë:

Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë	anëtar
Drejtori i Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Durrës	anëtar
Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Lezhë	anëtar
Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Punësimit dhe Aftësive Lezhë	anëtar
Drejtori Rajonal i Shërbimit Informativ të Shtetit Lezhë	anëtar
Drejtori IIEVP Shënkoll, Lezhë	anëtar
Drejtori i Degës Territoriale të Shërbimit të Proves Lezhë	anëtar
Drejtori i Degës Territoriale të Shërbimit të Proves Kurbin	anëtar
Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë	anëtar
Drejtori Rajonal i Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Shkodër	anëtar
Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër	anëtar
Drejtori i Rajonal i Inspektoriatit Shtetëror të Punës Shkodër	anëtar
Shefi i Sektorit të Policisë Kriminale të Policisë Ushtarake Rinas	anëtar

3. Në takimet e komitetit rajonal, kur vlerësohet e nevojshme dhe sipas çështjeve që do të trajtohen, me kërkesë të kryetarit, mund të ftohen të marrin pjesë kryetari i këshillit të qarkut, kryetari/kryetarët i/e të bashkisë/bashkive drejtuesit e prokurorive të rretheve gjyqësore, anëtarë të bashkësive fetare, përfaqësues nga shoqëria civile dhe organizata e agjenci të tjera.

4. Komiteti Rajonal ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Shërben si partner dhe autoritet përgjegjës në nivel qarku për zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit të rasteve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm pranë Koordinatorit kombëtar për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm.
- b) Identifikon dhe referon pranë qendrës së koordinimit kundër ekstremizmit të dhunshëm (QKEDH) individët apo grupet vulnerabël në rrezik radikalizmi apo të radikalizuar në nivel qarku nëpërmjet vlerësimit të raportimeve dhe problematikave të diskutuara në mbledhjet periodike nga anëtarët e komitetit rajonal.
- c) Në bashkëpunim me QKEDH-në, ndjek të gjitha veprimet, masat dhe aktorët e përfshirë në parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceset e rehabilitimit, rirntegrimit dhe risocializimit të personave të kthyer nga zonat e luftës.
- d) Kryen vlerësime periodike për fenomenin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në nivel qarku, në përputhje dhe në zbatim të strategjisë ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2023-2025 dhe planeve perkatëse të veprimit.
- e) Ndërmerr masa për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit me qëllim parandalimin e radikalizmit dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, nëpërmjet tryezave të rrumbullakëta, takimeve informuese dhe fushatave të ndërgjegjësimit për këtë qëllim.
- f) Shërben si urë lidhëse për trajtimin e nevojave sociale dhe ekonomike më të gjera të rasteve të identifikuar në rrezik radikalizmi apo të radikalizuara në qark.
- g) Zbaton me përgjegjësi të gjitha detyrat dhe udhëzimet e lëna nga kryetari i komitetit rajonal për parandalimin e radikalizmit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm.
- h) Raporton periodikisht një herë në tre muaj, nëpërmjet kryetarit të komitetit rajonal, te koordinatori kombëtar për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, për të gjithë veprimtarinë e tij. Raporti duhet të jetë produkt i punë të të gjithë anëtarëve të komitetit rajonal dhe përmbajtja e raportit duhet të japë informacion vetëm për periudhën për të cilën raportohet.
- i) Miraton rregulloren e funksionimit të komitetit rajonal në koordinim me QKEDH-në.
- j) I propozon koordinatori kombëtar për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm plane dhe strategji konkrete për adresimin e çështjeve e të problematikave që kanë të bëjnë me parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm si dhe rehabilitimin e të riatdhesuarve nga zonat e konfliktit.

5. Struktura e raportit sipas shkronjës "h", të pikës 4, të këtij urdhri, duhet të përmbajë:

- a) një përmbledhje të veprimtarisë së komitetit rajonal për periudhën për të cilën raportohet, si dhe informacione në fushën e veprimit të secilit anëtar;
- b) konstatime dhe problematika të hasura, si dhe propozime për adresimin e tyre;
- c) të dhëna statistikore apo tregues të arritjeve dhe rezultateve kryesore;
- ç) të dhëna statistikore të përditësuara për periudhën për të cilën raportohet;
- d) informacion për planifikimin dhe programet për të ardhmen;

5.1. Të dhënat statistikore të përditësuara për periudhën, për të cilën raportohet duhet të përfshijnë informacion të përpunuar, të ardhur nga të gjitha strukturat që janë pjesë e komitetit dhe të përmbajnë informacion në nivel qarku për:

- a) rastet apo fenomenet e evidentuara nga policia e shtetit;
- b) rastet apo fenomenet e evidentuara nga punonjësit socialë në njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- c) rastet apo fenomenet e evidentuara nga shërbimi informativ i shtetit;
- ç) rastet apo fenomenet e evidentuara nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale që veprojnë në qark;
- d) rastet apo fenomenet e evidentuara nga sistemi i arsimit parauniversitar;
- dh) rastet apo fenomenet e evidentuara nga sistemi i shëndetësisë;
- e) rastet apo fenomenet e evidentuara nga forcat e armatosura;
- ë) rastet apo fenomenet e evidentuara nga komunitetet fetare;
- f) rastet apo fenomenet e evidentuara nga shoqëria civile dhe organizatat joqeveritare që operojnë në qark
- g) rastet apo fenomenet e evidentuara nga aktorë të tjerë;

5.2 Raporti duhet të hartohet dhe të përcillet në formën e një shkrese zyrtare të nënshkruar nga prefekti i qarkut, në cilësinë e kryetarit të komitetit rajonal me datë dhe me numër protokollit të institucionit që e dërgon.

6. Kryetari i komitetit rajonal kryen këto detyra:

- a) Organizon dhe drejton veprimtarinë e komitetit bazuar në strategjinë ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2023-2025 dhe në planet e veprimit.
- b) Raporton një herë në tre muaj, në emër të komitetit rajonal te koordinatori kombëtar për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm për veprimtarinë e komitetit rajonal dhe proceset e rehabilitimit, riintegritit dhe risocializimit të personave të kthyer nga zonat e luftës në Siri dhe Irak në nivel qarku.
- c) Shërben si urë lidhëse koordinuese ndërmjet koordinatorit kombëtar për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe qarkut për bashkërendimin e veprimtarisë për parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceseve të rehabilitimit, riintegritit dhe risocializimit të personave të kthyer nga zonat e luftës në Siri dhe Irak.

7. Drejtori i përgjithshëm i qendrës së koordinimit kundër ekstremizmit të dhunshëm (QKEDH) është koordinatori kombëtar për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm (Koordinator Kombëtar).

8. Komiteti rajonal mbledhet, si rregull një herë në tre muaj, me kërkesë të kryetarit të komitetit rajonal, ky i fundit mund të mbledhet edhe më shumë se një herë në tre muaj. Në çdo rast, njoftohet paraprakisht koordinatori kombëtar për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm (Koordinator Kombëtar).

9. Komiteti rajonal mund të mbledhet dhe me kërkesën e koordinatorit kombëtar për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm në çdo moment, në raste urgjente dhe sa herë e gjykon të arsyeshme ky i fundit, me qëllim bashkërendimin e punës, trajtimin dhe adresimin e problematikave.

10. Anëtarët e komitetit rajonal të raportojnë periodikisht një herë në muaj sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, te kryetari i komitetit.


11. Në mbështetje të veprimtarisë së komitetit rajonal të ngrihet sekretariati teknik, i cili është pjesë e administratës së prefektit të qarkut. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të sekretariatit teknik percaktohet në rregulloren e funksionimit të komitetit.

12. Sekretariati teknik ka këto detyra:

- a) Mban kontakt me të gjithë anëtarët e komitetit rajonal, koordinatorin kombëtar për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm aktorët e tjerë që mund të ftohen në tryeza teknike me kërkesën e kryetarit të komitetit rajonal.
 - b) Njofton anëtarët për takimet e komitetit rajonal, si dhe siguron paraqitjen dhe shkëmbimin e materialeve për takimet e planifikuara.
 - c) Siguron zhvillimin e mbledhjes, shkëmbimin dhe administrimin e informacionit dhe të dhënave në nivel qarku për detyrat e caktuara nga komiteti rajonal.
 - ç) Harton raorte dhe plane pune të komitetit rajonal.
13. Me qëllim koordinimin e punës dhe shkëmbimin e përvajave pozitive, komiteti rajonal mund të organizojë tryeza ndër-institucionale teknike për këtë qëllim.
14. Për zbatimin e këtij urdhri mgarkohet administrata e prefektit, Sektori i monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara.
16. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 695 Prot.

Lezhë , më 06.09.2023

URDHËR

Nr. 55 datë 06 /09/2023

PËR NGRITJEN E TASK -FORCËS VENDORE PËR GARANTIMIN E SIGURISË NË SHKOLLA

Në mbështetje të pikës (e) të nenit 8, të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”

URDHËROJ:

- 1.Ngritjen e Task- Forcës Vendore për Garantimin e Sigurisë në Shkolla.
2. Miratimin e planit të masave për garantimin e perimetrit të sigurisë në shkolla, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Task- Forca Vendore për Garantimin e Sigurisë në Shkolla kryesohet nga Prefekti dhe ka në përbërje drejtuesit e institucioneve të mëposhtme:

Bashkia Lezhë

Bashkia Kurbin

Bashkia Mirditë

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lezhë

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kurbin

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Mirditë

Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit – Drejtoria Rajonale Lezhë

Inspektoriati Rajonal të Mbrojtjes së Territorit - Drejtoria Rajonale Lezhë

Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor Lezhë

4. Task- forca Vendore për Garantimin e Sigurisë në shkolla ka për detyrë:
Të zbatojë planin e masave sipas Urdhrit të Prefektit si dhe legjislacionit specifik, duke kryer monitorime/inspektime, në bashkëpunim, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

Të informojë Prefektin për punën e bërë, problematikat e konstatuara në mbarëvajtjen e këtij procesi, në adresën e e-mail prefektura_lezhe@yahoo.com.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


PREFEKTI

Gjergj PRENDI



Miratohet

P R E F E K T I
Gjergj PRENDI



Plani i masave për garantimin e sigurisë në shkolla

Nr	Problematika	Detyrat	Institucionet bashkëpunuese	Afati
1	Administrimi	Organizim i takimit me bashkitë, degët territoriale, inspektoriatet, përgjegjëse në fushën e garantimit të sigurisë në shkolla. Prezantimi i urdhrat të Prefektit për ngritjen e Task Forcës Vendore për Garantimin e Sigurisë në Shkolla.	Bashkia Lezhë, Bashkia Kurbin, Bashkia Mirditë : ZVAP Lezhë, ZVAP Kurbin, ZVAP Mirditë, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, AKU Lezhë, IKMT Lezhë, Inspektoriat Shtetëror Shëndetësor Lezhë	Brenda datës 08.09.2023
2	Siguria Publike	Identifikimi dhe përcaktimi i perimetrit të sigurisë në shkolla	Bashkitë Lezhë, Kurbin e Mirditë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë	Brenda datës 01.12.2023
		Monitorim i shtuar për identifikimin e individëve që merren me tregtimin e lëndëve narkotike dhe mbajtjen pa leje të armëve të ftohta dhe të zjarrit.	Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë	Në vazhdimësi
		Rritja e rolit ndërlidhës të oficerëve të sigurisë në shkolla për zbatimin e paketës ligjore mbi sigurinë. Ndërgjegjësimi i të rinjve dhe edukimi i tyre me kulturën e ligjshmërisë, për përdorimin korrekt të internetit dhe rrjeteve sociale, shmangien e bullizmit, krimit kibernetik në dëm të të miturve dhe parandalimin e situatave që vendosin në rrezik jetën dhe të ardhmen e brezit të ri.	ZVAP Lezhë, ZVAP Mirditë, ZVAP Mirditë, Drejtoria Vendore e Policisë	Në vazhdimësi

3	Siguria Rrugore	Vendosja dhe mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore, vertikale dhe horizontale, dhe semaforëve të nevojshëm në perimetrin e sigurisë në shkolla. Monitorimi I gjendjes së sinjalistikës së sigurisë.	Bashkitë Lezhë, Kurbin e Mirditë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë	Brenda datës 01.12.2023
		Mjetet për transportin e nxënësve të identifikohen me logot dhe shenjat përkatëse	ZVAP Lezhë, ZVAP Mirditë, ZVAP Mirditë	Në vazhdimësi
4	Siguria ushqimore	Realizimi i kontrolleve të shtuara në subjektet ushqimorë që ndodhen në perimetrin e sigurisë së shkollave	AKU Lezhë	Në vazhdimësi
5	Siguria urbane	Kryerja e kontrolleve të koordinuara për verifikimin e situatës në perimetrin e sigurisë të shkollave, për repektimin e rregullave të sigurisë së ndërtimit, eliminimit të rrënojave dhe papastërtive të çdo lloji për një mjedis të shëndetshëm.	Bashkitë Lezhë, Bashkia Kurbin, Bashkia Mirditë dhe IKMT - drejtoria rajonale Lezhë	Në vazhdimësi
6	Higjena & duhani, alkooli	Zbatimi i masës kufizuese të ndalimit të duhanit, jo vetëm në institucionet arsimore , por në të gjithë perimetrin e sigurisë	Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor Lezhë	Në vazhdimësi
		Monitorimi i zbatimit të normave higjeno-sanitare në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare	Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor Lezhë	Në vazhdimësi
		Monitorimi i tregimit të pijeve alkoolike për të miturit, veçanërisht në lokalet, në perimetrin e sigurisë së shkollave .	Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor Lezhë dhe Policia e Shtetit	Në vazhdimësi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 444 Prot.

Lezhë , më 15.5.2025

URDHËR

Nr. 60 datë 15/5.2025

**PËR NGRITJEN E TASK -FORCËS VENDORE NDËRINSTITUCIONALE TË SEZONIT
TURISTIK VEROR 2025 PËR QARKUN LEZHË**

Në mbështetje të pikës (e) të nenit 8, të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr.58, datë 06.05.2025 “Për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale të Sezonit Turistik Veror 2025”,

URDHËROJ:

- 1.Ngritjen e Task- Forcës Vendore Ndërinstitucionale të Sezonit Turistik Veror për qarkun Lezhë, që bashkëpunon me Komitetin Rajonal të Zhvillimit të Turizmit Lezhë dhe është përgjegjës për zbatimin në afat të masave përgatitore të përcaktuara në planin e masave për sezonin turistik veror.
2. Miratimin e planit të masave për sezonin turistik veror 2025, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Task- Forca Vendore Ndërinstitucionale për Sezonin Turistik Veror për qarkun Lezhë kryesohet nga Prefekti dhe ka në përbërje Drejtuesit e institucioneve të mëposhtme:

Bashkisë Lezhë

Bashkisë Kurbin

Bashkisë Mirditë

Agjencisë Rajonale të Bregdetit Lezhë

Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Lezhë

Drejtorisë Rajonale Lezhë të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

Drejtorisë Rajonale Lezhë të Inpektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit

Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë
Komisariatit Lezhë
Komandës së Forcës Detare Shëngjin
Stacionit për Kufirin dhe Migracionin Shëngjin
OSHEE Lezhë
Shoqërisë Rajonale të Ujësjetllës Kanalizime Lezhë
Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës
Drejtorisë Rajonale Shkodër të Autoritetit Rrugor Shqiptar
Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Lezhë
Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Lezhë
Drejtorisë Rajonale Shkodër të Inspektoriatit Shtetëror të Punës e Shërbimeve Shoqërore
Administratës së Zonave të Mbrojtura Lezhë

4. Task- forca vendore ndërinstitucionale për sezonin turistik veror për qarkun Lezhë ka për detyrë:
Të zbatojë planin e masave sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.58 datë 06.05.2025, si dhe këtij urdhri,
sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë dhe të informojë Prefektin për punën e bërë dhe problematikat
e konstatuara në vazhdimësi, gjatë sezonit turistik veror 2025.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PREFEKTI

Taulant Malshi



Plani i masave për Sezonin Turistik Veror 2025 , Lezhë

Nr.	Institucionet	Detyrat	Institucione bashkëpunuese
1	MTM	Organizim i takimit me bashkitë , degët territoriale, agjencitë, inspektoriatet, për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2025. Ngritja e grupit të punës ndërinstitucional, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.58, datë 06.05.2025.	Bashkia Lezhë, Kurbin, Mirditë, drejtuesit rajonalë/ vendorë pjesë e task forcës ndërinstitucionale për sezonin turistik veror 2025.
		Hartimi dhe zbatim i planeve për menaxhimin e mbetjeve urbane të ngurta dhe mbetjeve të tjera me impakt negativ në mjedis gjatë akteve kombëtare dhe atyre që cojnë në destinacione turistike. Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave nga zonat turistike drejt vend-depozitimeve të caktuara.	Bashkia Lezhë, Kurbin, Mirditë, ARM , Drejtoria Rajonale e Rrugëve Shkodër, Prefektura Lezhë
		Paraqitja në këshillin bashkiak dhe miratimi i planit lokal të zhurmave. Zbatim i programit të kontrollit për monitorimin e ndotjes akustike në zonat turistike.	Bashkia Lezhë, Policia e shtetit, Prefektura Lezhë
		Organizimi dhe mbështetja e aktiviteteve me natyrë argëtuese: kulturore, artistike, sportive etj. në bashkëpunim me Bashkinë, shoqata, etj. ku cdo aktivitet të jetë konform urdhrave të MSHMS. Të hartojë dhe publikojë kalendarin e festave lokale për vitin 2023.	Bashkia Lezhë, MTM, ISHSH Lezhë, Prefektura Lezhë
2	MIE	Në bashkëpunim dhe me strukturat e MTM, përcaktimi i zonave për ankorimin e mjeteve lundruese argëtuese, korridoret e hyrje-daljeve dhe përgatitja e hartës përkatëse për plazhet sipas VKM nr.321, dt 28.05.2014.	Komanda e Forcës Detare Shëngjin, ARM Lezhë, Shkodër, Kukës, Bashkia Lezhë, Prefektura Lezhë
3	MSHMS	Të bëhen inspektime dhe kontrole për respektimin e normave dhe rregullave higjieno sanitare në objektet turistike, restorante e struktura akomoduese.	Bashkia Lezhë, strukturat e MTM , Prefektura Lezhë
		Dezinfektimi i zonave bregdetare, ligatinore, qyteteve bregdetare. Kontributi në fushatat dhe aksionet e pastrimit të zonave turistike.	
4	MM	Angazhimi i FARSH në përputhje me planin e emergjencave civile gjatë sezonit turistik	Strukturat e MTM, Bashkia Lezhë, Prefektura Lezhë Prefektura Lezhë, Bashkia Lezhë, strukturat e MB e MTM
5	NJVV	Sigurimi i sinjalistikës së nevojshme në plazhe (rërë dhe ujë), për saktësimin e plazheve të menaxhuara dhe publike, si dhe për zonat ujore të lejuara dhe ato me rrezikshmëri.	Bashkia Lezhë, Prefektura Lezhë
		Marrja e masave për mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme, vijëzimin e rrugëve, vendosja e sinjalistikës dhe informacione në lidhje me shërbimet bazë: Polici, Spitale, Plazhe, Pika të vizitueshme, Rrugëve që të cojnë drejt destinacioneve turistike dhe ndriçimin e tyre.	Bashkia Lezhë, Kurbin , Mirditë Prefektura Lezhë
		Zhvillimi i stacioneve të plazhit publik me standarte të kushte higjieno sanitare sipas destinacioneve dhe tipologjive.	Bashkia Lezhë, Prefektura Lezhë
		Përcaktimi i vendparkimeve të automjeteve në zonat e plazheve.	Bashkia Lezhë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Prefektura Lezhë
		Hapja dhe vënia në funksion të plotë zyrat e informimit për turistët në qendrat e qyteteve dhe në afërsi të pikave turistike.	Bashkia Lezhë, Kurbin , Mirditë Prefektura Lezhë
		Vënia në dispozicion të pushuesve numrat e telefonit pranë NJVV për ankesat apo shërbimet e munguara ndaj tyre.	Bashkia Lezhë, Kurbin , Mirditë Prefektura Lezhë
		Zbatim i planeve për menaxhimin e mbetjeve urbane shtimi I kontenierëve dhe hartimi I planeve të qarta, me fasaha orare të përshtatshme për largimin e mbetjeve urbane në të gjithë destinacionet turistike	Bashkia Lezhë, Kurbin , Mirditë Prefektura Lezhë
Hartimi i një plan të qartë të depozitimit të mbetjeve nga subjektet turistike, me orare dhe vende të përcaktuara. Të monitorojë grumbullimin e mbetjeve deri në largimin e tyre drejt venddepozitimeve të përcaktuara.	Bashkia Lezhë, Kurbin , Mirditë Prefektura Lezhë		

		Përcaktimi i vend - depozitimeve të inerteve dhe mbetjeve të ngurta	Bashkia Lezhë, Kurbin , Mirditë Prefektura Lezhë
		Hartimi I kalendarit të festave lokale 2025 nga cdo bashki. Organizimi dhe mbarëvajtja e tyre si mundësi e mirë për promovimin e atraksioneve turistike dhe prodhimeve tradicionale të zonës.	Bashkia Lezhë, Kurbin , Mirditë Prefektura Lezhë
		Marrja e masave për furnizimin pa ndërprerje me ujë si dhe sistemimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza, veçanërisht në destinacionet turistike. Të përgatitet plani i koordinimit për ta patur nën kontroll situatën për çdo defekt të mundshëm gjatë gjithë sezonit turistik.	UK Lezhë, Bashkia Lezhë, Kurbin, Mirditë Prefektura Lezhë
6	Prefektura	Koordinimi përmes Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit Lezhë dhe monitorimi e bashkërendimi me Task-forcën vendore nderinstitucionale të sezonit turistik veror 2025, ngritur me urdhërin e Prefektit të veprimtarisë për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror .	Prefektura Lezhë , Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
		Ngritja e Task Forcës nga Prefekti, në kuadër të menaxhimit të sezonit turistik, e cila do të ndjekë zbatimin e masave në nivel qarku dhe do të raportojë pranë Ministrisë së Brendshme për zbatimin e detyrave dhe masave nga institucionet, pjesë e Task Forcës.	Prefektura Lezhë
		Koordinimi ndërinstoitual mbi monitorimin e pastrimeve frekvente në zonat turistike, organizimin e aksioneve për pastrimin e territoreve të zonave turistike, para dhe gjatë sezonit turistik veror	Prefektura Lezhë , Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 718 Prot.

Lezhë, më 25.07.2025

U R D H Ë R
Nr. 100 Datë 25.07.2025

PËR
NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT RAJONAL ANTITRAFIKIM PËR
QARKUN LEZHË

Bazuar në germën (e), neni 8 të ligjit nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, urdhrin nr. 94 datë 27.06.2025 të Kryeministrit "Për Ngritjen dhe Funkcionimin e Komiteteve Rajonale Antitrafikim",

URDHËROJ :

1. Ngritjen e funksionimin e Komitetit Rajonal Antitrafikim (në vijim, KRAT), në shkallë qarku, për të mbështetur e koordinuar përpjekjet për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.
2. Komiteti Rajonal Antitrafikim funksionon nën drejtimin e Prefektit të Qarkut dhe përbëhet nga drejtuesit e institucioneve vendore ose përfaqësues të tyre .
3. Komiteti Rajonal Antitrafikim përbëhet nga:

- Z. Taulant Malshi	Kryetar	Prefekt	Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë
- Z. Agron Ivani	Anëtar	Kryetar	Këshilli i Qarkut Lezhë
- Znj. Marte Fetaj	Anëtar	Drejtor	Bashkia Lezhë
- Z. Pashk Kaci	Anëtar	Sekretar i Përgjithshëm	Bashkia Kurbin
- Z. Aurel Çupi	Anëtar	Drejtor	Bashkia Mirditë
- Z. Mhill Luli	Anëtar	Nënprefekti Kurbin	Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë
- Znj. Vitore Gjini	Anëtar	Nënprefekti Mirditë	Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë
- Z. Anteo Memetaj	Anëtar	Shef	Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë
- Z. Fatjon Kopani	Anëtar	Shef	Stacioni i Policisë Kufitare Shëngjin
- Znj. Zoje Zefaj	Anëtar	Drejtor	D R Sh S Sh Lezhë
- Z. Agostin Marku	Anëtar	Drejtor	A K PA Lezhë
- Z. Viktor Shyti	Anëtar	Drejtor	Drejtoria Rajonale e SH I SH Lezhë
- Znj. Antoneta Suta	Anëtar	Drejtor	Z V A P Lezhë
- Znj. Teuta Mara	Anëtar	Drejtor	Z V A P Kurbin
- Z. Lek Nikolli	Anëtar	Specialist	Z V A P Mirditë
- Z. Elson Frroku	Anëtar	Drejtor	NJ V K SH Lezhë
- Znj. Megi Gjonaj	Anëtar	Drejtor	NJ V K SH Kurbin
- Znj. Jonida Imeri	Anëtar	Shef Sektori	NJ V K SH Mirditë
- Z. Salvator Bruka	Anëtar	Nëndrejtor	D S R Lezhë

- Znj. Edlira Lleshi Anëtar Drejtor D R SH S Kurbin
 - Z. Saimir Tuci Anëtar Specialist D R SH S "Shënjta Mari" Mirditë
 - Znj. Alvilda Kocaj Anëtar Përgjegjës Sektori I SH P SH SH Lezhë
4. Prefekti i qarkut, në cilësinë e kryetarit, nënshkruan memorandum/protokolle bashkëpunimi me prokuroritë përkatëse të gjykatës së shkallës së parë/apelit me juridiksion të përgjithshëm, si dhe me organizata joshtetërore, anëtare ose jo të Mekanizmit Kombëtar të Referimit me qëllim funksionimin sa më të mirë të KRAT-it dhe zbatimin e politikave antitrafikim.
5. Në takimet e KRAT-it, ftohen të marrin pjesë, sipas nevojave, përfaqësues nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, organizata me ekspertizë/të specializuara në fushën e antitrafikut, si dhe përfaqësues të tjerë, sipas nevojave specifike që mund të paraqiten rast pas rasti.
6. Ngritjen e funksionimit të Tryezës Teknike Antitrafikim, e cila kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Prefektit të qarkut, dhe ka në përbërje përfaqësues teknik nga secili institucion/organizatë që është pjesë përbërëse e KRAT-it. Bashkitë, në varësi të tematikave që trajtohen në takimet e tryezës teknike, përfaqësohen nga strukturat e migracionit/shërbimet sociale.
7. Tryeza Teknike përbëhet nga:
- Z. Ilir Ndoka Kryetar Sekretar i Përgjithshëm Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë
 - Znj. Xhyhere Frroku Anëtar Drejtor Kabineti Këshilli i Qarkut Lezhë
 - Znj. Anita Kadeli Anëtar Specialist Shërbime Sociale Bashkia Lezhë
 - Znj. Erleta Pjetri Anëtar Specialist Shërbime Sociale Bashkia Lezhë
 - Znj. Lindita Marku Anëtar Specialist Shërbime Sociale Bashkia Lezhë
 - Znj. Megi Matija Anëtar Përgjegjës Sektori Bashkia Lezhë
 - Znj. Vilma Kola Anëtar Përgjegjës Sektori Bashkia Kurbin
 - Znj. Marina Lula Anëtar Specialiste Migracioni Bashkia Kurbin
 - Znj. Rontila Jushi Anëtar Specialist Shërbime Sociale Bashkia Mirditë
 - Z. Mhill Luli Anëtar Nënprefekti Kurbin Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë
 - Znj. Vitore Gjini Anëtar Nënprefekti Mirditë Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë
 - Z. Selami Kalaj Anëtar Specialist Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë
 - Z. Zef Marku Anëtar Specialist Stacioni i Policisë Kufitare Shëngjin
 - Znj. Aldona Hasanaj Anëtar Specialist D R Sh S Sh Lezhë
 - Znj. Mimoza Prenga Anëtar Përgjegjës Sektori A K PA Lezhë
 - Z. Bardhok Gjini Anëtar Specialist Drejtoria Rajonale e SH I SH Lezhë
 - Znj. Lindita Prenga Anëtar Përgjegjës Sektori Z V A P Lezhë
 - Z. Zef Gjeta Anëtar Përgjegjës Sektori Z V A P Kurbin
 - Znj. Valbona Beleshi Anëtar Specialist Z V A P Mirditë
 - Znj. Marie Zefi Anëtar Specialist NJ V K SH Lezhë
 - Znj. Morena Suti Anëtar Specialist NJ V K SH Kurbin
 - Znj. Marjana Jushi Anëtar Specialist NJ V K SH Mirditë
 - Z. Erenik Lorenci Anëtar Specialist D S R Lezhë
 - Znj. Suada Bushi Anëtar Specialist D R SH S Kurbin
 - Z. Dorian Lazri Anëtar Specialist D R SH S "Shënjta Mari" Mirditë
 - Znj. Alvilda Kocaj Anëtar Përgjegjës Sektori I SH P SH SH Lezhë
8. Tryeza Teknike Antitrafikim mbledhet një herë në dy muaj/ose, në raste emergjence, edhe më shpesh dhe ka këto detyra:

- Identifikon problemet parësore në fushën e antitrafikut;
 - Mbledh e shkëmben të dhëna mbi identifikimin fillestar, referimin dhe zgjidhjen e rasteve konkrete;
 - Përcakton veprimet e nevojshme për parandalimin e trafikimit, mbrojtjen e familjeve, grupeve, personave dhe fëmijëve në rrezik trafikimi;
 - Organizon veprimtaritë/aktivitetet ndërgjegjësuese në bashkëpunim me aktorë të tjerë shtetërorë dhe joshtetërorë për parandalimin e trafikimit;
 - Raporton me shkrim pas çdo mbledhjeje pranë KRAT-it lidhur me veprimtarinë e Tryezës Teknike Antitrafikim, gjetjet, ecurinë e rasteve të trajtuara, si dhe adreson rekomandime për zgjidhje;
 - Organizon ngritjen e grupeve antitrafik në nivel bashkie apo njësie administrative.
9. KRAT-i në veprimtarinë e tij mbështetet nga sekretariati teknik i ngritur nga Prefekti.
10. KRAT-i ka për detyrë të planifikojë, koordinojë dhe të zbatojë masat për:
- Parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve edukative;
 - Identifikimin e hershëm të viktimave të mundshme të trafikimit nëpërmjet trajnimit të stafit vendor dhe bashkëpunimit me komunitetin;
 - Promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar në luftën kundër trafikimit;
 - Hartimin e programeve për menaxhimin e rasteve emergjente;
 - Sigurimin e mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegrimit të viktimave të trafikimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe organizatat;
 - Shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave ndërmjet institucioneve për identifikimin e ndjekjen penale të rrjeteve të trafikimit;
 - Monitorimin e situatës vendore lidhur me trafikimin e raportimin periodik te Ministria e Brendshme dhe strukturat e tjera qendrore.
11. KRAT-i duhet të zhvillojë mbledhje periodike (jo më pak se një herë në tre muaj) për të diskutuar progresin e veprimtarisë së tij dhe për të planifikuar veprimet e ardhshme. Në raste emergjente, KRAT-i mund të organizojë mbledhje të jashtëzakonshme.
12. KRAT-i harton e paraqet raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore për aktivitetet/veprimtarinë e tij dhe situatën vendore lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore pranë Ministrisë së Brendshme.
13. KRAT-i ka përgjegjësinë të trajtojë në mënyrë të sigurt e konfidenciale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësine, të gjitha të dhënat personale dhe informacionet që lidhen me viktimat e trafikimit.
14. Për zbatimin e këtij urdhëri, ngarkohen subjektet e përmendura në pikën 3.
15. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

P R E F E K T I

Taulant Malshi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË

SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË MBROJTJES CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 998 Prot.

Lezhë, më 14.10.2025

URDHËR

Nr. 130 datë 14.10.2025

Për "Ngritjen e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Mbrojtjes Civile dhe Krizave".

Bazuar në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, në ligjin nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", në VKM Nr. 923, datë 25.11.2020 "Për Funkcionimin e Organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional të Institucioneve dhe të Strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile", si dhe në Udhëzimin nr.16, datë 11.07.2003 "Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të planifikimit dhe përballimit të mbrojtjes civile, në nivel qarku".

URDHËROJ:

1. Të ngrihet komisioni i planifikimit dhe përballimit të mbrojtjes civile dhe krizave për koordinimin dhe menaxhimin e situatave nga fatkeqësitë natyrore në shkallë qarku, me këtë përbërje:

Nr.	Funksioni Institucional	Detyra
1	Prefekti	Kryetar
2	Kryetari i Këshillit të Qarkut	N/Kryetar
3	Përgjegjësi i Sek.Planifikimit e Përballimit të MC dhe Krizave.	Sekretar
4	N/Prefekti Kurbin	Anëtar
5	N/Prefekti Mirditë	"
6	Sekretari i Përgjithshëm	"
7	Dretori i Policisë Vendore të Qarkut	"
8	Komandanti i blk të Reagimit të Shpejtë, Laç (Vau-Dejes)	"
9	Përgjegjësi i Sek.Monitorimit,Komp.Vendore dhe Funk.Deleg.	"
10	Përgjegjësi i Sektorit të Zhvillimit Urban	"
11	Përgjegjësi i Sektorit Juridik	"
12	Përgjegjësi i Sektorit të Finances dhe Shërbimeve	"
13	Drejtori i Portit	"
14	Drejtori Rajonal i Ujitjes dhe Kullimit	"
15	Drejtori Rajonal i Eksensionit Bujqësisë	"
16	Drejtori Rajonal i Autoritetit Kombëtar i Ushqimit	"
17	Drejtori i Ujësjellës-Kanalizimeve	"
18	Drejtori i OSHEE Lezhë	"
19	Drejtori i Njësisë së Kujdesit Shëndetësor	"
20	Drejtori Rajonal i Arsimit Parauniversitar	"
21	Drejtori i Doganës	"
22	Drejtori i Tatim Taksave	"
23	Drejtori Rajonal Verior i ARRSH Shkodër	"
24	Drejtori Rajona i IKMT-së	"
25	Sekretari Rajonal i Kryqit të Kuq Lezhë	"
26	Kryetari i Bashkisë Lezhë	"
27	Kryetari i Bashkisë Mirditë	"
8	Kryetari i Bashkisë Kurbin	"

- b- Për zjarret: -Stacionet e MZSH në Bashkitë Lezhë, Mirditë, Kurbin,
-Agjensia Rajonale e Zonave të Mbrojtura.
- c- Për tërmetet: -Të gjitha strukturat shtetërore vendore e qendrore,
-Komanda e b1k të Reagimit të Shpejtë, Laç (Vau-Dejës).
- d- Për aktet terroriste: -Drejtoria Vendore e Policisë të Qarkut,
-Forcat Speciale Anti-Terror.
- e- Për bllokimin e rrugëve: -Drejtoria Rajonit Verior të ARRSH-së,
-Bashkitë Lezhë, Mirditë, Kurbin
-Drejtoria Vendore e Policisë, Sektori Qarkullimit Rrugor.
- a+b+c+d+e (për arsimin): -Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
-Njësitë e Vetëverisjes Vendore.

4. Për marrjen dhe përpunimin e informacionit, dhe shpërndarjes së ndihmave, në rastet e shpalljes të gjendjes së mbrojtjes civile, caktoj:

- a- Për informacionin: (Prefekti + Bashkitë)
- b- Për shpërndarjen e ndihmave: (Prefekti + Bashkitë)

5. Në takimet e Komisionit të PPMC&K, ftohen të marrin pjesë drejtuesit e degëve territoriale, shoqata humanitare, OJQ, bisnese etj. në nivel qarku, mbi marrjen e masave në zbatim të programit të qeverisë në kuadrin e planizimit dhe përballimit të mbrojtjes civile.

6. Bazuar në VKM nr.329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" dhe në VKM nr.414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, të ngrihet komisioni i ekspertëve për vlerësimin e dëmeve që mund të shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore.

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

P R E F E K T I

Taulant MALLSHI

